



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 51 prot. i AK, datë 18.01.2023 “Njoftim në zbatim të pikës II të Vendimit nr. 917, datë 24.10.2022 të Komisionit të Konkurrencës”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me themelimin e një joint – venture, të kontrolluar nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.

Referuar dokumentit “Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë Durrës-Marina SHA”, palët janë:

Pala 1: Shoqëria Albanian Seaports Development Company SHA (ASDC) është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Koordinimin dhe administrimin e proceseve të lidhura me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”; administrimin e pasurive dhe shërbimeve jashtë terminaleve në përdorim të Autoritetit Portual Durrës, si dhe çdo pronë/pasurie që mund t’i kalohet në pronësi; përkujdesjen dhe zbatimin e rregullave të administrimit përsa i përket territoreve dhe ambjenteve të Autoritetit Portual të Durrësit etj.

Kjo shoqëri kontrollohet 100% nga Autoriteti Portual i Durrësit. Autoriteti Portual Durrës kujdeset për shërbimet dhe kushtet e hyrje-daljes së mjeteve lundruese, si dhe për sigurinë e turistëve në hapësirën portuale, duke siguruar menaxhim eficient për komunitetin e transportit, për klientët portualë, përdorimin e faciliteteve të portit, duke ofruar shërbim cilësor e të besueshëm për kalimin e mallrave nga transporti detar në atë rrugor, hekurudhor me çmime konkurruese dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të ruajtjes së mjedisit.

Pala 2: Shoqëria Eagle Hills Real Estate SHPK (Eagle Hills) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Zhvillimin dhe ndërtimin e pasurive të paluajtshme, dhënien me qera të pasurive të paluajtshme dhe çdo aktivitet tjetër në lidhje me pasuritë e paluajtshme.

Kjo shoqëri kontrollohet 100% nga North East Real Estate Holdings Limited, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas Ligjeve të Abu Dhabi. North East Real Estate Holdings Limited zotërohet 100% nga Symphony Global Holdings Limited, themeluar në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Shoqëria e përbashkët (JV): Durrës Marina SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Qëllimi i vetëm i shoqërisë është të ushtrojë biznesin, që nënkupton zhvillimin e një resorti të pasurive të paluajtshme për përdorime të ndryshme si edhe të marinës në Territorin e Projektit, në përputhje me Master Planin dhe Master Planin e Marinës, si dhe operimin dhe menaxhimin e veprimtarive të ndryshme të biznesit në pajtim me Planin e Biznesit dhe Planin e Biznesit për Marinën

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.